



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT

FUSHA: KARRIERA DHE AFTËSIMI PËR JETËN

MODULI: GUIDA TURISTIKE

KODI: 5.01

**PROGRAMI I MODULIT “GUIDA TURISTIKE”
PËR KLASËN 10**

TIRANË, NENTOR 2008

Ky modul zhvillon te nxënësit aftësi për të dalluar rolin dhe rëndësinë e guidës turistike në industrinë e turizmit si dhe duke përdorur njohuri të fituara edhe në lëndë të tjera në lidhje me vlerat natyrore, kulturore, historike, etj, t'i promovojnë këto nëpërmjet përdorimit të teknikave të thjeshta të drejtimit të grupeve turistike.

1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të zhvillimit të modulit “Turizmi dhe guida turistike”, nxënës/i,-ja :

- të shpjegojë rëndësinë ekonomike dhe sociale për zhvillimin e turizmit;
- të klasifikojë llojet dhe format e turizmit;
- të dallojë elementët bazë të nevojshëm për të zhvilluar turizëm të qëndrueshëm;
- të vlerësojë lidhjen e turizmit me bukuritë natyrore, trashëgimisë kulturore dhe historike të vendit
- të dallojë llojet dhe format e ndërmarrjeve turistike;
- të dallojë rolin e guidës turistike në drejtimin e grupit turistik dhe në promovimin e vlerave të vendit;
- të dallojë përjasjet e traditave të ndryshme kulturore të turistëve ndaj fenomeneve të ndryshme;
- të hartojë itinerar turistik;
- të përdorë itinerar turistik dhe teknika të udhëheqies së grupit turistik vende të ndryshme.

2. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

Linja: Roli i guidës turistike në industrinë e kohës së lirë dhe turizmit

Nxënës/i,-ja zhvillon konceptet fillestare mbi turizmin, elementët e tij bazë si dhe për rolin e guidës turistike për vlerën ndaj produktit turistik të shitur, ashtu dhe për promovimin e vlerave kombëtare të vendit.

Orë të sugjeruara 20

Linja	Objektiva
Roli i guidës turistike në industrinë e kohës së lirë dhe turizmit	<p>Në përfundim të klasës 10-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë dallimin ndërmjet kohës së lirë dhe turizmit; - të dallojë llojet dhe format e turizmit; - të shpjegojë lidhjet mes pejsazhit natyror dhe turizmit; - të shpjegojë lidhjet mes kulturës dhe turizmit; - të dallojë llojet dhe format e ndërmarrjeve turistike; - të shpjegojë kuptimin për itinerarin; - të dallojë llojet e itinerarit; - të shpjegojë veçoritë e itinerarit turistik; - të shpjegojë kuptimin për guidën turistike; - të dallojë veçoritë e guidës turistike në raport me format e tjera të

	<p>guidave;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë rolin e guides turistike për promovimin e vlerave të vendit; - të dallojë veçoritë e guidave turistike sipas llojit; - të shpjegojë cilësitë e guiderit turistik; - të dallojë veçoritë e guiderëve turistikë sipas veprimtarisë që ata kryejnë; - të shpjegojë veçoritë e turistëve sipas llojit; - të dallojë veçoritë e komunikimit me turistët; - të shpjegojë ndjeshmëritë e turistëve sipas prejardhjes kulturore; - të shpjegojë veçoritë psikologjike të grupit turistik.
--	---

Linja: Udhëheqja e grupit turistik

Nxënës/i,-ja aftësohet për hartimin e itinerarit turistik dhe për zbatimin në praktikë të teknikave të drejtimit të grupit.

Orë të sugjeruara 16

Linja	Objektiva
Udhëheqja e grupit turistik	<p>Në përfundim të klasës 10-të nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ndërtojë itinerar turistik për një destinacion të caktuar; - të shpjegojë veçoritë e guidës në këmbë në zona të banuara (qytet, fshat); - të udhëheqë një grup duke zbatuar teknikat e guidimit në zona të banuara (qytet, fshat); - të shpjegojë veçoritë e guidës në një vend arkeologjik; - të udhëheqë një grup të simuluar duke zbatuar teknika të guidimit në një vend arkeologjik; - të shpjegojë veçoritë e guidës në një museum, galeri arti; - të udhëheqë një grup të simuluar duke zbatuar teknika të guidimit në një museum, galeri arti; - veçoritë e guidës në vende të shenjta (kisha, xhami etj); - të udhëheqë një grup të simuluar duke zbatuar teknika të guidimit në vende të shenjta (kisha, xhami etj).

3. KËRKESA TË MODULIT “GUIDA TURISTIKE” NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Guida turistike	1. Matematika
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kryejë veprime matematikore në funksion të llogaritjes së kurseve të këmbimit, ose konvertimit të monedhave të huaja në monedhën vendase.

Guida turistike	2. Gjuha shqipe dhe letërsia
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë kuptimin e termave dhe të koncepteve gjuhësore si: turizëm, guidë turistike, destinacion turistik, promovim, tipologjia, motivimi për të udhëtuar, menaxhimi, konflikti, komunikimi, menaxhimi i kohës, etj; - të përdorë elemente të të shprehurit në mënyrë figurative dhe të saktë dhe bindëse; - të përdorë forma të ndryshme komunikimi në situata të ndryshme; - të shprehë opinione, të arsyetojë, diskutojë, argumentojë dhe të bëjë debat në lidhje me tematika që lidhen me historinë, letërsinë, fenë, politikën, artin, mënyrën e jetësës etj; - të dëgjojë me vëmendje, të reagojë me takt dhe të kontrollojë emocionet.
Guida turistike	3. Gjuha e huaj
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të flasë rrjedhshëm dhe saktë gjuhën e përditshme; - të transmetojë saktë informacione në gjuhë të huaj në lidhje me bukuritë natyrore, historike, kulturore, fetare, etj - të shfrytëzojë fjalorin terminologjik në gjuhë të huaj për termat më të përdorshme në fushën e turizmit.
Guida turistike	2. TIK
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë programe të ndryshme për punët e pavarura dhe prezantimet e ndryshme (si ëord, excel, poëer point etj); - të përdorë komunikimin elektronik (e-mail, rrjetin e brendshëm, internetin etj.) për të komunikuar dhe bashkëpunuar me Agjensinë turistike apo me destinacionin e ardhshëm.
Guida turistike	3. Njohuri për ekonominë
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë rolin e degëve të veprimtarive të ndryshme ekonomike në shoqëri; - të shpjegojë thelbin e ekonomisë së tregut dhe mekanizmat e funksionimit të saj; - të shpjegojë pse turizmi është i klasifikuar në sektorin e shërbimeve; - të shpjegojë pse të ardhurat nga turizmi konsiderohen si të ardhura nga eksporti; - të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të turizmit për rritjen e punësimit veçanërisht në zonat, që konsiderohen

	desinacion turistik.
Guida turistike	4. Gjeografia
Për të gjitha linjat	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë veçoritë klimaterike, bukuritë natyrore, të zonave të caktuara të vendit; - të shfrytëzojë mjete mësimore si hartat, globin etj.; - të përdorë hartën për të përcaktuar dhe analizuar rajone të ndryshme; - të shpjegojë fenomenin e migrimit dhe ta analizojë atë si një fenomen negativ për nenvlerësimin, deri në zhdukjen e vlerave kombëtare, që duhet të mbron dhe zhvillohet nga vetë popullsia sipas zonave.

5. KËRKESAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për t'u zbatuar në modulën "Guida turistike". Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurikulare e gjimnazit. Hartimi i programit është mbështetur te korniza kurikulare.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmenduar.

Në kornizën kurikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurikulës së gjimnazit,
- synimeve të linjave ndërkurikulare,
- vlerësimit të nxënësit me notë,
- parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurikulare dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin programin e modulit "Guida turistike".

Përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Objektivat

Objektivat e programit janë detyrim për të gjithë përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësit duhet të nxënë çka përshkruhet në objektiva. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit. Kështu, për shembull, objektivi: "Nxënës/i/ja të dallojë veçoritë e guidës turistike në raport me format e tjera të guidave", do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të njohin llojet e guidave turistike, veçoritë e tyre në mënyrë që të bëjnë dallimin e tyre me guidën turistike.

Një objektivi mund të përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm.

Udhëzime për realizimin e orëve mësimore

Programi "Guida turistike" është strukturuar në dy linja që vijnë njera pas tjetrës. Linja e parë fokusohet në aspekte kryesisht teorike që synojnë të realizojnë të kuptuarit për rëndësinë

dhe vendin që ze guida turistike në industrinë e kohës së lirë dhe turizmit. Në mënyrë graduale nxënësi duhet të fokusohet nga një veshtrim i përgjithshëm e sipërfaqësor për turizmin, llojet/format e tij, për llojet e ndërmarrjeve turistike te guida turistike. Nëpërmjet punëve në grup apo të atyre të pavarura nxënësi duhet të aftësohet për të interpretuar dhe përdorur një itinerar turistik. Pjesa më e konsiderueshme e kohës në këtë linjë i duhet kushtuar realizimit të objektivave që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me guidën turistike, guiderëve turistikë, turistëve apo grupit turistik, kjo jo vetëm nëpërmjet dhënies dhe kontrollit të njohurive por kryesisht nëpërmjet detyrave të pavarura dhe punëve me projekte.

Linja e dytë ka kryesisht karakter praktik dhe synon aftësimin e nxënësit për të planifikuar, udhëhequr në mënyrë të simuluar sipas teknikave të duhura një grup (nxënës, mësues etj).

Programi “Guida turistike” është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës.

Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të modulit, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e modulit “Guida turistike” afërsisht 40% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 60% e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen e njohurive-bazë (konceptet themelore),
- vlerësimin e njohurive-bazë,
- integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhëse,
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (integrimi do të përshkojë zhvillimin e çdo ore mësimore),
- detyrat/ projektet përmbledhëse vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja lënda duhet parë si një e tërë).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive dhe aftësive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t’i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme si komunikimi, menaxhimi dhe transferimi i informacionit, të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimi i karakterit dhe i etikës;
- aftësive të posaçme lëndore në lidhje paraqitjen e vendit të guides turistike ne raport me industrinë e kohës së lire dhe turizmit si dhe me forma të tjera të guidave, interpretimin e itinerareve turistike, zbatimin e teknikave të thjeshta të udhëheqjes së grupeve turistike;
- formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t’u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është vlerësimi i realizimit të objektivave, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah shkallën e realizimit dhe të përforcojë, të përmirësojë njohuri e aftësi të pa përmbushura të kësaj lënde.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi.

Vlerësimi i nxënësit është konsistent me objektivat e programit lëndor.

Objektiv i vlerësimit janë njohuritë, shprehitë dhe qëndrimet e nxënësve (qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti).

Vlerësimi i nxënësit mund të bëhet në mënyrë individuale ose në grup. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim apo nëpërmjet veprimtarive të tjera.

Në këtë lëndë nxënësi vlerësohet për portofolin e detyrave, për prezantimet e realizuara në përputhje me formularët standardë të përcaktuar nga mësuesi.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Për linjën e dytë krahas instrumenteve të tjera të vlerësimit, duhet të përdoret lista e kontrollit për vlerësimin e demonstrimit të nxënësit.

Nuk është i detyrueshëm vlerësimi me notë i nxënësve në çdo orë mësimore.

Mësuesi duhet tu parashtojë nxënësve qëllimin, kriteret dhe instrumentet e vlerësimit.

Portofoli i punëve të nxënësit është një nga mundësitë kryesore të vlerësimit për mësuesin dhe të vetëvlerësimit për nxënësin.